



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 25, datë 03.02.2023

**PËR**

**MIRATIMIN E LISTËS SË GJASHTË PARAPRAKE TË 24 FAMILJEVE, QË KANË HUMBUR SHTËPITË INDIVIDUALE SI PASOJË E SHEMBJES NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONAVE TË REJA**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr.97/2019; VKM nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar; VKM nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, dhe sipas relacionit të hartuar nga Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në Bashkinë Durrës, si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e listës së gjashtë paraprake të 24 familjeve, që kanë humbur shtëpitë individuale si pasojë e shembjes nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, të cilët do të përfitojnë nga programi i zhvillimit të zonave të reja, pasqyruar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij, hartuar nga Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 07.02.2023**



ANEKSI I. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TE ZONAVE TE REJA

NR	NJESIA ADMINISTRATIVE	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PERBERJA FAMILJARE	STRUKTURA E BANESES	ZONA E RE
1	ISHEM	AFRIM	MERSIN	DIJA	5	3+1	SPITALLE
2	ISHEM	ASLLAN	RESHIT	ALLA	7	3+1	SPITALLE
3	ISHEM	AVNI	SHEFQET	SHEHU	3	2+1	SPITALLE
4	ISHEM	BAJRAM	HAXHI	SHEMLIKAJ	6	3+1	SPITALLE
5	ISHEM	BENARDO	XHEMALI	MUZHAQI	3	2+1	SPITALLE
6	ISHEM	HAXHI	ISMAIL	MUZHAQI	5	3+1	SPITALLE
7	ISHEM	ILIRJAN	JUSUF	SHEHU	5	3+1	SPITALLE
8	ISHEM	KADRI	SELMAN	GJYLI	5	3+1	SPITALLE
9	ISHEM	LIMAN	VESEL	FILI	7	3+1	SPITALLE
10	ISHEM	LULZIM	DALIP	MEZINI	6	3+1	SPITALLE
11	ISHEM	MALIQ	GANI	KULLA	4	2+1	SPITALLE
12	ISHEM	MARK	PASHK	BRAHJA	4	2+1	SPITALLE
13	ISHEM	MINUSHE	SALI	SADIKU	5	3+1	SPITALLE
14	ISHEM	MUSTAFA	DERVISH	SHEHU	4	2+1	SPITALLE
15	ISHEM	PASHK	MARK	BRAHJA	3	2+1	SPITALLE
16	ISHEM	QAMIL	SULEJMAN	GJOZI	4	2+1	SPITALLE
17	ISHEM	QEMAL	MALIQ	JANGU	2	1+1	SPITALLE
18	ISHEM	RAMAZAN	IDRIZ	MERDITA	2	1+1	SPITALLE
19	ISHEM	RIFAT	MALIQ	GJYLI	6	3+1	SPITALLE
20	ISHEM	SHYQYRI	SELMAN	MESITI	7	3+1	SPITALLE
21	ISHEM	TEFIK	OSMAN	SABAHI	7	3+1	SPITALLE
22	ISHEM	VESEL	ISMAIL	KERTUSHA	2	1+1	SPITALLE
23	ISHEM	XHELAL	MUHARREM	DERVISHI	1	1+1	SPITALLE
24	ISHEM	ZEF	VLASH	CERRI	1	1+1	SPITALLE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës


Nr. 108/prot.  
2

Durrës, më 14.02.2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.25 datë 03.02.2023 “Për miratimin e listës së gjashtë paraprake të 24 familjeve, që kanë humbur shtëpitë individuale si pasojë e shembjes nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, të cilët do të përfitojnë nga programi i zhvillimit të zonave të reja”

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

